



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 21 janar 2013
Nr. ref.: RK353/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI87/12

Parashtrues

Afrim Rexhepi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme,
Ap. Nr. 119/2010, të 10 tetorit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Afrim Rexhepi, me vendbanim në Prishtinë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Ap. nr 119/2010, e 10 tetorit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 30 dhjetor 2011.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi ankohet për bashkimin e dënimit unik dhe për refuzimin e ankesës së tij si të pabazuar.

Baza juridike

4. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 1 tetor 2012, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatë.
6. Më 31 tetor 2012, Kryetari e caktoi Gjyqtarin Almiro Rodrigues Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Robert Carolan (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Enver Hasani.
7. Më 3 nëntor 2012, Sekretariati i dërgoi një shkresë parashtruesit, duke kërkuar që ai ta plotësojë kërkesën për Gjykatën Kushtetuese. Më 14 nëntor 2012, duke mos marrë parasysh atë që u tha më lart, Sekretariati e informoi parashtruesin se kërkesa e tij ishte regjistruar.
8. Më 14 nëntor 2012, Sekretariati e informoi Gjykatën Supreme për kërkesën e parashtruesit.
9. Më 30 nëntor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë ia dërgoi Sekretariatit kopjen e nënshkruar të fletëkthimit të Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme të Kosovës. Sipas fletëkthimit të nënshkruar, parashtruesi e ka pranuar Aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Supreme më 30 dhjetor 2011.
10. Më 21 janar 2013, pas shqyrtimit të Raportit të Gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

11. Më 10 tetor 2011, Gjykata Supreme e Kosovës nxori aktgjykimin e kontestuar (Ap. Nr. 119/2010) dhe aprovoi ankesën e Prokurorit Publik përkitazi me dënimin.
12. Prandaj, Gjykata Supreme i shqiptoi parashtruesit dënimin unik me burg në kohëzgjatje 3 (tri) vjet dhe (2) dy muaj. Ankesa e mbrojtësit të parashtruesit të kërkesës ishte hedhur poshtë si e pabazuar.

Pretendimet e parashtruesit

13. Parashtruesi kërkon nga Gjykata Kushtetuese "që të hapë hetime ndaj të përfshirëve në këtë Aktgjykim, sepse si pasojë e njerëzve të përfshirë në të unë jam i dëmtuar dhe jam dënuar me 3 vite e 2 muaj burgim pa pasur faj edhe pse unë kam qenë i rrezikuar me

armë zjarri askush nuk e ka marrë parasysh këtë, dhe unë nuk jam një njeri i tillë siç më ka përshkruar prokurori publik”.

14. Parashtruesi nuk tregon asnjë të drejtë ose liri themelore apo ndonjë dispozitë kushtetuese, e cila pretendohet të jetë shkelur me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës.

Pranueshmëria e kërkesës

15. Neni 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] i Kushtetutës përcakton:

“Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

16. Gjykata i referohet nenit 49 [Afatet] të Ligjit, që parasheh:

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht. Nëse kërkesa është e drejtuar kundër një ligji, atëherë afati fillon të ecë që nga dita kur ligji ka hyrë në fuqi”.

17. Për më tepër, rregulli 36 [Kriteret e Pranueshmërisë] i Rregullores së punës parasheh:

“Gjykata mund t’i shqyrtojë kërkesat vetëm nëse:

b) kërkesa parashtrohet brenda katër muajsh nga dita e dorëzimit të vendimit të mjetit të fundit juridik efektiv të parashtruesit”.

18. Gjykata vëren se vendimi i plotfuqishëm i gjykatës ishte marrë nga Gjykata Supreme (Ap. nr. 119/2010) më 10 tetor 2011 dhe iu dorëzua parashtruesit më 30 dhjetor 2011.
19. Gjykata vëren më tej se kërkesa e parashtruesit iu dorëzua Gjykatës Kushtetuese më 1 tetor 2012, d.m.th., pothuajse dhjetë muaj pas afatit të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit.
20. Kështu, kërkesa nuk është dorëzuar në Gjykatë në mënyrë ligjore, siç është përcaktuar me nenin 113 (1) të Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 36.1 (b) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani